



Në emër të Allahut, të Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotit

## **Parathënia**

Duke e parë nevojën e madhe për takimin e nxënësëve tanë në Zvicër, lindi ideja që të organizohet ndonjë vendtakim, mirpo ky do të ishte i zbehtë nëse nuk ka ndonjë aktivitet që do të ndërmeret. Kjo fuqi na shtyni që gjatë sezonit verorë të organizohen takime sportive e gjatë dimrit ( e sidomos në Ramazan) garime në dituri islame.

Hera e parë e këtij lloji organizimi mori jetën e tij në vitin 1999 ku imami i xhamisë Wil, bëri një Kuiz në dituri në mesin e nxënësëve të kësaj xhamie.

Zhvillimi njerzorë bën që njeriu të mendojë edhe më thellë dhe të gjejë metodë edhe më interesante dhe më të zgjëruar. Kjo inicoi në atë që në herat tjera të ftohen xhamiat që veprojnë në Zvicër.

Ky organizim i vitit 2003 në pjesmarrje të 12 qendrave islame të Zvicrës, dhe e mbajtur në sallë e qytetit – Will, shënoi kulminacion të kuizit deri më sot.

Will-i dhe të tërë nxënësit mburen me këtë mikpritje që iu bëhet mysafirëve tanë nga xhamiat motra të Zvicrës.

Xhamia Wil

## KUIZI 2003

Që në mbledhjen e rregullt të tetorit të Imamëve në Zvicër erdhi në rend të ditës Kuizi. Pasi në Wil është shëndruar në traditë të ftohen nxënësit që një muaj më herët ju ofrohen 300 pyetje me përgjigjet e tyre, në gara diturie, vendoset që ky kuiz të mbahet në Wil.

Dëshirat ishin që ky rast të mbahet në një vend më të gjërë për shkak të prezencës dhe interesimit të madh të xhemateve të Zvicrës.

Në formë shumë të shpejtë, më mirë thënë duke u konsultuar Imamët mes veti, salla e qytetit të Will-it u rezervua për 19.11.2003 ( e mërkurë). Ishim të vetëdijshëm se kjo ditë ishte një ditë pakashumë e rëndë për nxënësit, mirpo nuk kishim zgjedhje të shumta para vetes.

Po në këtë mbledhje u caktua komisioni që do merret me përgaditjen e pyetjeve dhe me jurinë në ditën e mbajtjes së kuizit, të cilët ishin:

- Rejhan Neziri – Imam në Kreuzlingen
- Nebi Rexhepi – Imam në Zürich
- Rexhail Aziri – Imam në Reinach



Reth një muaj para terminit, aritën pyetjet e formuluar nëpër xhami që kishin të drejtë të benin paraqitjen për kuiz deri më 15.11.2003.

Për nxënësit xhamia Wil ofron iftar dhe kjo do të ndihmojë edhe më shumë që nxënësit të jenë, hanë dhe gjenden sëbashku, qëllim i parë dhe i fundit yni. Aty u propozuar dhe u vendos që udhëheqjen ta bëjë aktivisti i njohur i xhamisë Biel Bienne, Naxhi Ibrahim.



Nxënësit do të shpërblehen në këtë formë:  
Vendi i parë krahas dhuratës së një simboli islam, nga Fr. 150.- në  
nxënës, i dyti nga 100.- e i treti nga 50.-

Erdhi kjo ditë së shpejti. Rinia e xhamisë u  
nda në dy grupe, njëra do të merret me  
rregullimin e sallës e tjetra me ndihmën  
gjatë iftarit.



Stadtsaal – Wil

Në iftarin e bujshëm me ushqim nga xhemati i Wil-it morrën pjesë  
vetëmse 5 xhamia (nxënës) të cilët pas ngrënjes guxuan të shkonin në  
sallë ku do të mund të bënin parapërgaditje të duhura, përdërisa prindërit  
dhe xhemati do ta falnin namazin e taravisë.

Tashmë ora 21.00. Para neve prezentohet një skemë e dekoruar dhe me  
një projektor që prezenton një pamje të padëmshëme në shiqimin e  
pjesmarrësit. Kush ndanë mendimin me ata se islami nuk i jep të drejtë  
femrës, sot do ta ndjente vehten në të padrjetë, sepse këtu në këtë  
publik me afro 450 pjesmarës nuk mungonte edhe motra muslimane.

Nga tre Imam tanit, me zërin e tyre atraktiv në formë paralele lexohen tre  
ezana, pas të cilit udhëheqësi programit, z. Naxhi Ibrahim fillon  
programin duke iu dhënë fjalën Imamit nikoqir, Bekim Alimi dhe kryetarit  
të këshillit të kësaj qendre Islame, z. Agim Bahtiri.

Tashmë në skenë paraqitet njëri grup i  
nxënësve, dmth gjashtë të parit kurse grupi  
i dytë duheshte ta pres kualifikimin e këtij  
rundi.

Këta gjashtë xhamiat pjesmarrëse në  
grupin e parë ishin:



Pamje nga një ekip nxënësish

1. Xhamia Wil
2. Xhamia
3. ..
4. ..
5. ..
6. ..

Pas një sëri pyetjesh të cilat guxonin fëmijët ti zgjedhin në formë të numrave psh. C3 ose A4 etj. që u parashtruan nga moderatori  
 .....

Në skenë paraqiten gjashtë grupet tjera e këta të parët duhet të pushojnë dhe t`ju japin rastin të dytëve për paraqitje.

1. ....
2. ....
3. ....
4. ....
5. ....
6. ....

Pas rundit të parë për rifreskim të atmosferës së rënduar u lexuan diesa ilahije dhe për shkak të kohës së ngushtë duheshte të nazhdohet me rundin e dytë menjëherë.

Në klasifikimin e mëtutjeshëm mbeten finalistët të cilët ishin Rorschach, Grenchen dhe Biel Bienne. Në një gabim të vogël rëshqesin nxënësit e Rorschach-it dhe në finalen e madhe mbeten dy grupet e Zvicrës francezo-perendimore. Pas pyetjeve të shumta detyrohet komisioni të pyes jasht materialit përshkak se nuk kishte diçka nga materiali që këta vogëlush musliman që nuk e dinin.

Pas një gabimi të vogël, bie grupi i Grenchen-it dhe vendoset në pjedistalin më të lartë të këtij tubimi madhështor, Biel Bienne me merita të plota.



Para përfundimit të tubimit i kthehet mikrofonit Imamit nikoqir i cili falenderon prezentuesit dhe shpreson në aktivitete edhe më të mira nga kjo e Wil-it.



Vendi i Parë – Biel Bienne

Nxënësve ju ndahen dhuratat e premtuara dhe ata mbeten në skenë duke u fotografuar me prindërit e tyre njerëz të ndryshëm.



Nxënësit me organizatorët



Këshilli organizativ dhe prof. Mahir Hasani

## **Intervistat:**

### **Prof. Mahir Hasani, profesor i gjuhës arabe në Medresenë „Isa Beg“ Shkup**

Nëse gjatë Ramazanit ka pasur ndonjë ditë më festive, ajo do të ishte e sodit. Vogëlushet dhe vogëlushët e bashkëatdhetarëve tanë sot do të shprehin diturinë e fituar. Kënaqësi e papaërshkruar për të gjithë ne që jemi mysafir në Zvicër e në veçanti për prindërit e këtyre fëmijëve,

### **Abi Muhtari-Gostivar**

Jam shumë i lumtur që edhe muslimanët dimë të organizojmë diçka të tillë në formë perfekte.

### **Ahmed Memedi - Imam në xhaminë St.Gallen**

Organizimi i Kuzit është në nivel, pra ka përparim të dukshëm nga ai i vitit të kaluar. Ky përparim ofron shpresë për një organizim më të profesionalizuar.

### **Imbërja Asani-Xhemat në xhaminë e Wil-it**

Gjithçka msohet për fenë tonë është mirë, e sdomos kënaqësi është për mua kur shoh vajzat dhe djemt të barabartë mësojnë.

### **Unë jam një anëtarë i xhamisë së Zürich-ut**

Jam tepër i kënaqur, Allahu ju shpërbleft

### **Abdilsami Misimi-Imam në Frauenfeld**

Ndjehem shumë mirë. Deri më tani ka rrjedhë shumë mirë, më tutje të shohim, inshaallah mirë.

## **Harbin Jonuzi-Imam në fsh. Sllatinë-Tetovë (Mysafir Imam në xhaminë Visp)**

Shumë i kënaqur ndjehem që në këto vise të perendimit nxënësit tanë të gjitha moshave fëmijore të mësojnë fenë e Allahut.

## **Nimetullah Hoxha-Imam në Rebstein**

Kjo punë është e lëvdruar në Kur`an dhe hadith. Thot Muhamedi a.s. „ Më i miri ndë ju është ai që e mëson Kur`anin dhe ua mëson të tjerëve“. Pra në këto troje është rëndë të msohet islami, por në këto mënyra do të ishte një motivim.

## **Bejtullah Asani-xhemat në xhaminë Reinach**

Përshtypje të veçantë na ka lënë ky Kuiz dhe poashtu si rrjedh programi është kënaqësijë.

## **Kumrije Osmani – nxënëse nga Tetova**

Kuizi është një die shumë e qëlluar ngase ka pyetje të cilat as ne të riturit nuk i dimë fare.

***Ngase ti je nga Will-i dhe e ndjeke rastin me ekipën e Wil-it, çka mendon, a iu bë padrejtësi këtij ekipi?***

Une mendoj se po, se në rradhën e parë kur u përgjegj nxënësi e tha të tërë përgjigjen por me ndërprerje. Komisionit i takon ta grumbullojë përgjigjen dhe ta notojë, e jo ta shtyejë nxënësin edhe një herë të përgjigjet.

## **Ramije Alimi-Teologe**

Organizimi i mrekullueshë, komplimente.

## ***Ç`kishte negative nga shiqimi juaj?***

Në skenë në fillim të programit u paraqitën shumë njerëz që nuk kishin ndonjë funksion.

### **Gani Misimi - Imam në Biel Bienne**

Falemnderit për mikpritjen, është një atmosferë imponante e sidomos ndjehem i kënaqur me ekipin e Biel Bienne që mori vendin e parë.

### ***Dihet se vitin e kaluar ke reaguar se sipas mendimit tënd në kuiz ka pasur shumë padrejtsi, çka mendon sivjet?***

Është fakt se gabimet dhe padrejtsitë janë natyrë njerzore, vetëm Zoti nuk gabon, sivjet mendoj se ka qenë shumë në rregull.

### **Rejhan Neziri- Imam në xhaminë Kreuzlingen**

**\* Anëtarë i komisionit \***

Është hera e parë që marr pjesë në një juri të tillë dhe jam i emocionuar tepër. Ne si njerëz tentojmë të jemi të drejtë kurse drejtsia absolute i takon Allahut xh.sh.

Imamët, xhematët dhe nxënësit mendojmë se kanë qenë të kënaqur, lus Allahun të na ndihmojë për rradhat tjera e sidomos atyre që nuk kanë marrë pjesë me nxënësit e tyre.

### **Nebi Rexhepi-Imam në Zürich**

**\*Anëtarë i komisionit\***

### ***Mollah Nebij, flitet në mes të xhematit se ai i cili gjinjë anon kah nxënësit e tij (më shumë se imamët tjerë) je ti, kurse ju sot nuk kishit rastin të jeni deri në finale, ç`është komenti juaj?***

Është më se reale që një mësues apo hoxhë të anon kah nxënësit e tij edhe pse përputhem në mendime me ju si organizatorë të kuizit se gjithë nxënësit janë tonit. Rasti i këtij kuizi më gëzon pamasë e sidomos në këto vende të perendimit ku inicitativa është private e jo shtetërore.

**Naxhi Ibrahim-xhemat nga Biel Bienne**  
**\*Udhëheqës i programit\***

Përshëndetje Imamit të xhamisë Will, Këshillit dhe xhamisë së tij për një organizim të nivelit të lartë. Thejst thënë MREKULLI.

**Amira Jashari-dhe Merita nxënëse pjesmarëse nga Biel Bienne**  
**\* Fituese e vendit të parë\***

Kuizi ka qenë shumë më i mirë në krahasim me vitin e kaluar dhe nuk kemi gjet asgjë negative.

Fjala përfundimtare

Gjithçka që fillon edhe mbaron, ja kështu edhe mbaroi ky aktivitet. ....

## Përmbajtja

1. Parathënia.....
2. Rrjedhja e Kuizit.....
3. Pyetjet dhe përgjigjet.....
4. Intervistat.....
5. Shema e rundeve.....
6. Fotogaleri.....
7. Fjala përfundimtare.....